



qendra e provimeve

**MASA**

E VËRTETË

E NJOHURIVE

**GARAT  
SHTETËRORE**

**2018**

SHIFRA E NXËNËSIT

SHKOLLA FILLORE

**BIOLOGJI**

NUMRI I PËRGJITHSHËM I PIKËVE TË FITUARA

Testin e kontrolloi



## **UDHËZIM**

**Të dashur garues,**

**Testi nga biologjia është paraparë të punohet 120 minuta.**

**Testi detyrimisht të punohet me laps kimik (lapsin grafit mund ta përdorni gjatë punës, mirëpo përgjigjja përfundimtare duhet të jetë e shkruar me laps kimik).**

**Përgjigjet të cilat nuk janë të shkruara qartë ose që janë përmirësuar nuk do të vlerësohen me pikë, prandaj mendohuni mirë para se të bëni zgjidhjen përfundimtare.**

**Ju dëshirojmë punë të mbarë!**



**1) Cila pjesë e qelizës te euglena e gjelbër siguron energjinë e nevojshme për lëvizje?**

- a) ciliet
- b) ribozomet
- c) kërbacët
- d) kloroplasti
- e) mitokondret

1

**2) Çfarë është e përbashkët për fotosintezën dhe frymëmarrjen qelizore?**

- a) marrin pjesë në prodhimin e materieve organike
- b) lirojnë energjinë e domosdoshme për funksionimin e qelizës
- c) mundësojnë qarkullimin e dioksidit të karbonit dhe ujit në natyrë
- d) kryhen në të gjitha qelizat e gjalla
- e) kryhen vetëm në qelizat eukariote

1

**3) Soja në qelizat e veta seksuale ka 20 kromozome. Në laboratorin gjenetik është krijuar lloji i ri i sojës me 54 kromozome në qelizat trupore. Për sa është rritur numri i kromozomeve në qelizat seksuale të lloji i ri i sojës në raport me llojin e pranishëm?**

- a) për 14
- b) për 34
- c) për 7
- d) për 13
- e) për 27

1

**4) Çfarë krijohet nga ajo që është dhënë më poshtë vetëm me procesin e mitozës?**

- a) veza e shiritit
- b) zigoti i krimbit të shiut
- c) bakteriofagu
- d) bulat e sfungjerëve
- e) spermatozoidi i peshqve ashtëror

1

**5) Për bakteret dhe viruset e përbashkët është se posedojnë:**

- a) ribozomet
- b) materialin gjenetik
- c) membranën qelizore
- d) citoplazmën
- e) mitokondriet

1

**6) Çfarë nga ajo që është dhënë më poshtë duhet të përmbajë mushti i fituar nga rrushi që me procesin e fermentimit ta shndërrojë në verë:**

- a) dioksidi i karbonit
- b) myqet
- c) bakteret
- d) alkooli
- e) tharmi

1

**7)** Çfarë nga ajo që është dhënë më poshtë nuk mund të jetë karakteristikë e kërpudhave saprofitë:

- a) shkaktojnë prishjen e ushqimit
- b) shfrytëzohen për gatimin e brumërave
- c) nxisin vlimin alkoolik
- d) shkaktojnë sëmundje të ndryshme
- e) jetojnë në simbiozë me organizmat tjerë

1

**8)** Cili nga grupet e dhëna sistematike përfaqëson botën:

- a) kurrizorët
- b) farëveshurat
- c) kërpudhat
- d) viruset
- e) likenet

1

**9)** Çfarë nga ajo që është dhënë më poshtë nuk është e përbashkët për meduzën dhe anemonën e detit:

- a) tipi i simetrisë
- b) notimi aktiv
- c) tipi sistemit nervor
- d) u përkasin grykorëve
- e) Prania e qelizave të zjarra

1

**10)** Nëse ndonjë organizëm ka tre segmente trupore, barkun pa këmbë dhe një palë krah, ai mund të jetë:

- a) bletë
- b) mushkonjë
- c) çimkë
- d) thnegla
- e) karkaleci

1

**11)** Çfarë nga ajo që është dhënë më poshtë vlen për algat:

- a) janë vetëm organizma planktone
- b) sipas ndërtimit mund të jenë njëqelizor, kolonial dhe shumëqelizor
- c) posedojnë organe vegjetative, por jo edhe reproduktive
- d) si organizma më të ulët shumëzohen vetëm në mënyrë joseksuale
- e) i përkasin botës bimore

1

**12)** Sistemi i mbyllur i gjakut ka:

- a) krimbi i shiut
- b) planaria
- c) krimbi i fëmijëve
- d) trematodi

1

**13)** Çfarë nga ajo që është dhënë vlen për latimerinë:

- a) u përket peshqve me korac
- b) paraardhësi i peshqve
- c) kanë skelet kërcor
- d) nuk ka fshikëzën e peshkut
- e) u përket peshqve krospterid

1

**14)** Salamandra e shpellave:

- a) merr frymë vetëm me anë të lëkurës
- b) tërë jetën mbetet në stadin larvë
- c) në ujërat e ftohta vendos vezët, ndërsa në ujin e ngrohtë pjellë të vegjlit e gjallë
- d) kur pjekët metamorfozon në adult
- e) lloji kosmopolit

1

**15)** Cila nga vetitë e dhëna janë të përbashkëta për troftën, tritonin dhe gjarpri:

- a) luspat
- b) tipi i sistemit nervor
- c) lëkura jargëzore
- d) mushkëritë

1

**16)** Çfarë nga ajo që është dhënë më poshtë për muskujt nuk është e saktë?

- a) gjatë kohës së trajnimit në ata zërthehet glikogjeni
- b) kanë rol të rëndësishëm në mbajtjen e pozitës së drejtë të kurrizit
- c) lëshohen pas ndalesës së veprimit të ngacmimit
- d) tonusi muskolor është prezent edhe në gjendje të qetësisë, për të cilin janë përgjegjës qendrat në trurin e mesëm
- e) për kontraktimin e zemrës përgjegjës janë muskujt e lëmuar

1

**17)** Shpesh ndodhë, kur jemi të sëmurë, nuk arrijmë të ndalim kollitjen. Shkak për këtë është fakti se kollitja është:

- a) nën kontrollin e qendrës në trurin e mesëm
- b) refleksi i kushtëzuar
- c) refleksi i lindur
- d) aktivitet i lartë nervor
- e) nën kontrollin e sistemit autonom nervor

1

**18)** Rretho rrugën e saktë të kalimit të ajrit gjatë frymëmarrjes së miut të pyllit:

- a) zgavra e hundës → gabzherri → laringu → gurmazi → bronket → mushkëritë
- b) zgavra e hundës → laringu → laringu → gabzherri → bronket → mushkëritë
- c) zgavra e hundës → laringu → gurmazi → gabzherri → bronket → mushkëritë
- d) zgavra e hundës → gurmazi → laringu → ezofagu → bronket → mushkëritë

1

**19)** Timusi është gjëndër e gjoksit funksioni dhe madhësia e të cilës ndryshojnë gjatë jetës. Çfarë nga ajo që është dhënë vlen për timusin?

- a) tajit hormone të cilat rregullojnë shpejtësinë e metabolizmit
- b) krijon antitropa në lidhje me shkaktarët e sëmundjeve
- c) njëra nga rolet është që të zërthejë eritrocitet e dëmtuara dhe të harxhuara
- d) ka funksionalitet më të madh tek fëmija sesa tek adoleshentët
- e) ka masë më të madhe tek fëmija sesa te adoleshentët

1

**20)** Nga çiftet e eshtrave të dhënë rrethoni dy të cilët nuk janë në lidhur me lidhje të lëvizshme:

- a) brinjët – ashti i gjoksit
- b) ashti i tëmthit – ashti i pykor
- c) ashti i krahërorit – ashti i bërrylit
- d) ashti ballor – ashti i tepës
- e) brezi i kombliku – ashti i kofshës


2

**21)** Përgjigjuni në kërkesat e kërkuara:

a) Në fushat e dhëna shënoni shkronjat përkatëse ashtu që të fitohet renditja e saktë e lëvizjes së valës së zërit deri te momenti i krijimit i ndjenjës së zërit.

A – kanali i jashtëm i veshit; B – eshtrat e të dëgjuarit; C – lapra e veshit; D – qendra për dëgjim;

E – Organi i Kortit; F – timpani i veshit; G – nervi i dëgjimit; H – kemoreceptori; I – qendra e dëgjimit; J – lëngu i brendshëm i veshit




b) Keni kujdes që në mes të nocioneve të ofruara në detyrën e mëparshme ekziston një i cili nuk bën pjesë në përbërjen e shqisës së të dëgjuarit. Tregoni me të cilën shkronjë është shënuar nocioni i cili nuk bën pjesë në shqisa dhe cilës shqisë/shqisave ai mund t'u përkas.

c) Shënoni në cilën pjesë të SNQ gjendet qendra për dëgjim? Përgjigjja duhet të jetë plotësisht e saktë. \_\_\_\_\_

5

**22)** Me shënimin e shkronjave përkatëse në katrorë, radhitni saktë, strukturat e dhëna, sipas shkallës së ndërlikueshmërisë së organizimit trupor, duke filluar nga më e thjeshta tek ajo më e komplikuar:


A – biceps; B – organizmi; C – indi muskolor; D – miofibrilet;  
E – sistemi muskolor; F – fija muskulore; G – miozina






**23)** Radhitni vetitë e dhëna të qelizave në varësi nga ajo nëse karakterizojnë qelizën bimore, shtazore ose qelizën bakteriale, duke shënuar shkronjat përkatëse (A – I) në diagramin e Venit duke marrë parasysh edhe zonat e përputhshmërisë (vetitë e përbashkëta).

A – përmban kloroplaste; B – materiali gjenetik gjendet në bërthamë; C – posedon murin qelizor; D – përfaqëson organizmin e pavarur; E – plaket dhe pas një kohe të caktuar vdes; F - ADN gjendet në citoplazmë; G – përmban gjenet përgjegjëse për trashëgim; H – posedon membranën qelizore; I - mund të krijojë indin ashtëror



**24)** Radhitni vetitë e dhëna të peshqve në varësi nga ajo nëse janë karakteristike për troftën ose rraxhën, duke shënuar shkronjat përkatëse (A – H) në diagramin e Venit, duke marrë parasysh edhe zonat e përputhshmërisë (vetitë e përbashkëta).

A – kanë linjën anësore; B – kanë fshikzën e peshkut; C – trupi i mbuluar me luspa; D – kanë të çarat e vezave; E – kanë frytnimin e jashtëm dhe vendosin vezët; F – kanë skelet kërcor; G – posedojnë kapakun e vezave; H – vrima e gojës gjendet në pjesën barkore të trupit



**25)** Lidhni saktë çdo nocion të shënuar në anën e djathtë, me nga një përshkrim i cili i përgjigjet, duke shënuar shkronjën përkatëse në kllapa:

- |   |     |                      |
|---|-----|----------------------|
| a) aftësia e lëvizjes aktive  | [ ] | trashëgimia          |
| b) shkëmbimi i materies dhe energjisë me mjedisin                   | [ ] | ngacmueshmëria       |
| c) renditja e individëve në hapësirë                                | [ ] | rritja dhe zhvillimi |
| d) ndryshimet të cilat shpien deri te ndërlikueshmëria e ndërtimit  | [ ] | përshtatshmëria      |
| e) aftësia e reaksionit në informacionet nga mjedisi                | [ ] | metabolizmi          |
| f) krijimi i trashëgimtarëve të ngjashëm me veten                   |     |                      |
| g) zhvillimi i vetive të cilat mundësojnë jetën në mjedisin e dhënë |     |                      |

3

**26)** Lidhni saktë secilin nga grupet e organizmave të cilët janë shënuar në anën e djathtë, me një organizëm të cilit i përket, duke shënuar shkronjën përkatëse në kllapa:

- |                                 |     |                   |
|---------------------------------|-----|-------------------|
| a) laminaria                    | [ ] | butakët           |
| b) trikina                      | [ ] | krimbat shpatuk   |
| c) guaca e detit                | [ ] | alget             |
| d) anemona e detit              | [ ] | protozoa          |
| e) ushunjëza                    | [ ] | krimbat unazor    |
| f) tripanozoma                  | [ ] | myshqet           |
| g) myshku Polytrichum attenatum | [ ] | krimbat cilindrik |
| h) ehinokokus                   |     |                   |
| i) pulmonari                    |     |                   |

3

**27)** Lidhni saktë secilin nga grupet e organizmave të cilët janë shënuar në anën e djathtë, me përshkrimin i cili i përgjigjet, duke shënuar shkronjën përkatëse në kllapa:

- |  |     |                        |
|--|-----|------------------------|
| a) numri i individëve të një lloji për metër katror            | [ ] | nataliteti             |
| b) rritja e numrit të individëve si pasojë e shumëzimit        | [ ] | gjysmëparazitizmi      |
| c) gjethimi i pyjeve   | [ ] | simbioza               |
| d) ndërrimi i një ekosistemit me tjetrin                       | [ ] | dendësia e popullacion |
| e) yvelli i lisit  | [ ] | gjendja e klimaksit    |
| f) bakteri në lëvoren e jonxhës                                | [ ] | periodizmi sezonal     |
| g) numri i përgjithshëm i individëve të një lloji në vendbanim |     |                        |
| h) stadi përfundimtar në formimin e biocenozës                 |     |                        |
| i) mbyllja e gjetheve të kurorës së tulipanit                  |     |                        |

3

**28)** Lidhni saktë radhët e gjitarëve të dhënë në anën e djathtë, me llojet e gjitarëve të cilët u përkasin, duke shënuar shkronjën gjegjëse në kllapa:

- |                     |     |            |
|---------------------|-----|------------|
| a) rinoceronti      | [ ] | balenat    |
| b) lakuriqi i natës | [ ] | egërsirat  |
| c) delfini          | [ ] | thundrorët |
| d) iriçi            | [ ] | brejtësit  |

- e) shimpanzeja [ ] kiropterët  
 f) qeni [ ] njëthundrak  
 g) devja [ ] primatët  
 h) ketri


3

**29)** Duke shënuar shenjën + në fushën përkatëse të tabelës renditni saktë bimët e dhëna varësisht nga ajo cilit kat të bashkësisë pyjore i takojnë:

	Kati i drunjëve	Kati i shkurreve
blini		
drizë		
shtogu		
molika		
panjë		
thana		

3

**30)** Shikoni figurën e dhënë të fryteve dhe farërave (1-6) dhe luleve (7-12), dhe pastaj përgjigjuni në pyetjet e kërkuara.



**A.** Përgjigjuni në pyetjet e shtruara të cilat kanë të bëjnë me farëra dhe fryte (figurat 1–6) duke shkruar numrin përkatës (ose më shumë numra) mbi vijat e zbrazëta:

- a) vetëshpërndarja: \_\_\_\_\_  
 b) përhapja me anë të erës: \_\_\_\_\_  
 c) përhapja me shtazë: \_\_\_\_\_  
 d) fryti i përbërë: \_\_\_\_\_

**B.** Përgjigjuni në pyetjet e shtruara të cilat kanë të bëjnë me lule (figurat 7–12) duke shkruar numrin përkatës (ose më shumë numra) mbi vijat e zbrazëta:

- a) plehërimi me anë të insekteve: \_\_\_\_\_  
 b) pa PISTIL: \_\_\_\_\_  
 c) pa mbështjellësin e lules: \_\_\_\_\_  
 d) lulesat: \_\_\_\_\_

9


Për lulet (d.m.th. numrat) që i keni shënuar si lulesa, shkruani cili tip i lulesave është në pyetje:

6

**31)** Vërtetoni cili nga pohimet e dhëna (a-i) është i saktë, gjegjësisht të pasakta, duke rrethuar shkronjën përkatëse (S ose P).

a) bimët dyvjeçare lulëzojnë vitin e parë, kurse frytin e japin vitin e dytë	S	P
b) sqepi i gjatë dhe këmbët e gjata e të holla janë adaptim i shpezëve notuese	S	P
c) paralizën e fëmijëve e shkakton lloji i caktuar i virusit	S	P
d) faza e parë e zhvillimit të gjitarëve të rinj e cila krijohet nga zigoti është fetusit	S	P
e) pështyma përmban enzimën maltaz që zbërthen amidonin deri në sheqerna të thjeshtë	S	P
f) e përbashkëta për tharmet dhe sfungjerët është shumëzimi joseksual me bulim	S	P
g) me mbirjen e spores të myshqeve krijohet protaliumi	S	P
h) zambakët e detit janë lloje të grykorëve	S	P
i) keratina është proteinë e pranishme në lëkurë, të thundrorët dhe njëthundrorët	S	P

**32)** Shikoni figurat e dhëna (1-5), dhe pastaj përgjigjuni në pyetjet e shtruar.



**A.** Më poshtë janë dhënë katër grupe të jorruzorëve (a–d). Nga kafshët e paraqitura në figura vërtetoni cilit nga grupet e dhëna u përkasin, duke shënuar numrin përgjigjës (ose më shumë numra) mbi vijat bosh:

- a) Gaforret: \_\_\_\_\_  
 b) Araknidet: \_\_\_\_\_  
 c) Insektet: \_\_\_\_\_  
 d) Shumëkëmbëshit: \_\_\_\_\_

**B.** Çfarë nga ajo që është dhënë më poshtë vlen për gaforret:

- a) kanë tri segmente trupore  
 b) një çift antena  
 c) kanë katër palë të ekstremiteteve gojore  
 d) kanë rajonin kokë-gjoks dhe barkor

e) posedojnë trake


f) dy çifte antena

C. Për organizma që i keni shënuar se u përkasin instekteve, në fushën e lënë bosh nën figurën gjegjëse shënoni cilit grup konkret (rëndit) të insekteve i përkasin.

5


**33)** Në figurën e mëposhtme është paraqitur skema e ndërtimit të syrit. Në bazë të përshkrimit të disa pjesëve të syrit, plotësoni saktë fushat boshe në tabelë, ashtu që çdo përshkrimit t'i bashkoni numrin gjegjës nga figura dhe të shkruani emërtimin e saktë të asaj pjese të syrit.

Përshkrimi i pjesës së syrit:	Emërtimi i pjesës së syrit:	Numri:
përmban konet dhe kleçkat		
përmban muskujt të cilët kontrahohen në mënyrë refleksive		
mbështjellësi i jashtëm i mollzës së syrit		
Masa zhelatinoze në brendësinë e mollzës së syrit		
Gjendet në mes të iridës dhe trupit qelqor		
mbron syrin, por është tejdukshme		
Gjatë dritës së fortë ngushtohet		



7

**34)** Në figura me hijezim janë shënuar disa pjesë të trurit dhe janë shënuar me numrat 1 deri në 4. Duke shikuar figurat përgjigjuni në pyetjet e shtruara.



Pas aksidentit në komunikacion, Maria ka pasur disa probleme të mëdha shëndetësore.

A) Një ndër problemet ka qenë çrregullim në drejtpeshim dhe koordinimin e lëvizjes. Ky problem është shkaktuar me lëndimin e pjesës së trurit të shënuar me numrin/numrat: \_\_\_\_\_

B) Maria gjithashtu ka pasur problem edhe me gëlltitje, dhe nuk ka mundur të ndiej aromën e ushqimit.

Shkak i kësaj është lëndimi i pjesës së trurit i shënuar me numrin/numrat: \_\_\_\_\_

C) Çfarë është shënuar në figurë me numrin 4? \_\_\_\_\_

Nëse Maria e ka lënduar atë pjesë të trurit, cila do të mund të ishte pasoja e atij

lëndimi:

- a) pamundësia e të mësuarit dhe të kuptuarit
- b) çrregullimi i frymëmarrjes
- c) ndjenja e pakontrolluar e urisë
- d) pamundësia e kryerjes së punëve refleksive
- e) çrregullimi në punën e hipofizës
- f) asgjë nga ajo që është dhënë

5

**35)** Në figurën e mëposhtme është paraqitur një fshikëz e mushkërive. Përgjigjuni në pyetjet e parashtruara:


a) Me cilin numër është shënuar gjaku i cili rrjedh nëpër arterien mushkërore? \_\_\_\_\_

b) Me cilin numër është shënuar gjaku i deoksigjenuar? \_\_\_\_\_


c) Çfarë është shënuar në figurë me numrin 3? \_\_\_\_\_

d) Fshikëza e mushkërore quhet edhe \_\_\_\_\_

4



**36)** Shikoni zinxhirin e të ushqyerit dhe pastaj përgjigjuni në pyetjet e parashtruara.



a) Shpenzuesit e fundit në zinxhirin e paraqitur të ushqyerit janë:

b) Sa anëtarë përbën zinxhiri më i gjatë i të ushqyerit, dhe sa më i shkurtri në këtë zinxhir?

c) Nëse nga bashkësia zhduket skifteri, ajo do të ndikojë më së shumti në rritjen e numrit të cilës kafshë? \_\_\_\_\_

Për cilën arsye? \_\_\_\_\_

3

**37)** Përgjigjuni në pyetje:

A. Rrënja e lules qumështore është:

- a) rrjetore      b) boshtore
- c) bishtore     d) gjembaçe

B. Lulet e qumështores janë:

- a) individuale
- b) të bashkuara në lulesa çadër
- c) të mbledhura në lulesa kokë
- d) formojnë lulesa në formë të kallëzës
- e) formojnë një tip tjetër të lulesave



C. Për qumështoren vlen:

- a) gjethet posedojnë nervaturën rrjetore
- b) familjes të cilës i përket qumështorja gjithashtu u përkasin edhe dhiozma dhe bari i kaçakut
- c) qumështorja është bimë e gjelbër, dhe kështu u takon monokotileve
- d) fara e qumështores kryesisht përhapet me anë të kafshëve
- e) familjes të cilës i takon qumështorja gjithashtu u përkasin edhe kamomili dhe luledielli

f) meqenëse është e pranishme gati në të gjitha kontinentet përfaqëson llojin endemik

4

**38)** Tabela e mëposhtme përmban 5 kolona dhe në çdo kolonë janë shënuar nga 6 nocione. Detyra juaj është që në çdo kolonë të gjeni nocionin i cili nuk bën pjesë në atë kolonë dhe atë nocion ta shënoni në fund të kolonës. Pastaj, mbi vija më poshtë, shënoni sqarimet (*pa sqarim përgjigjja nuk vlerësohet*).

1.	2.	3.	4.	5.
sëmundja e gushës	majmuni	gypi i urinës	bërsheni	dhelpra
akromegalia	tigri	nefroni	qeparisi	peshkaqeni
Sëmundja e kushingut	miu	mëshikëza e urinës	cikasi	krokodili
diabeti	ariu	veshka	dëllinja	kameleoni
rakitisi	koalë	prostata	qarr	gjarpërusha e detit
Sëmundja e adisonit	kali	urinmbajtësi	velviçia	salamandra
NUK BËN PJESË:	NUK BËN PJESË:	NUK BËN PJESË:	NUK BËN PJESË:	NUK BËN PJESË:

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

4. \_\_\_\_\_

5. \_\_\_\_\_

5











